

Për:	Operatori Ekonomik: “GRANITI” SH.P.K. – Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	13.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **12.04.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “GRANITI” SH.P.K. me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT, TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATAT E AQP-së**, me Numër të prokurimit: **623-23-1684-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-021-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “GRANITI” SH.P.K. me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT, TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATAT E AQP-së**, me Numër të prokurimit: **623-23-1684-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-021-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **05.04.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT, TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATAT E AQP-së**, me Numër të prokurimit: **623-23-1684-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-021-1-2-1**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: “GRANITI” SH.P.K. me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME INVENTAR PËR NEVOJAT E KOMUNËS SË RAHOVECIT, TË CILAT NUK JANË TË PËRFSHIRA NË KONTRATAT E AQP-së**, me Numër të prokurimit: **623-23-1684-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-021-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **05.04.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **12.04.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

1. Ju keni rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk ka prezantuar në ofertë deklaratën për afatin e validitetit, ndërsa tek dosja e tenderit neni 24.1 është specifikuar si në vijim: “Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë”.

Për të dëshmuar faktin se periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 90 ditë i njëjti është dashur të prezantoj deklaratën për afatin e vlefshmërisë së tenderit, ashtu siç e kemi prezantuar ne. Përderisa nuk është prezantuar deklarata e tillë, atëherë kuptohet qartë se i njëjti OE është i papërgjegjshëm.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar.

Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Operatori Ekonomik propozuar për Kontratë ka ofruar bashkë me ofertën e tij edhe vlefshmërinë e Tenderit e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar as një lloj deklarate për vlefshmëri të tenderit ngase ofrimi i një deklarate të tillë është i pa nevojshme.

Sipas paragrafit 3 të nenit 56 të LPP-ës, Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

2. I njëjti OE është i papërgjegjshëm për faktin se nuk ka ofertuar konform specifikimeve teknike të detyrueshme në paramasë. I njëjti për artikullin nr.8 ku është kërkuar: *“karrige lëvizëse me mbështetëse të krahëve nga druri”*

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e ka ofruar karrigen lëvizëse me mbështetëse të krahëve nga druri, konform kërkesës së dosjes së tenderit, sepse i njëjti ka prezantuar karrigen lëvizëse me krah të plastikes, e jo nga materiali i drurit. Andaj ky fakt tregon qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e specifikacioneve të detyrueshme ashtu si qeshte kërkuar nga ju ne dosje të tenderit.

I njëjti tek katalogu i prezantuar shihet qartë se karriga e prezantuar është me krah të plastikës dhe jo nga druri ashtu siç është kërkuar, ndërsa me poshtë keni edhe foto ilustrimin.



Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se ju keni rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana juaj.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatohet se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 të LPP-së.**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj nuk qëndron.

Kërriga e ofruar nga OE i rekomanduar për Kontratë për të cilën ju pretendoni se nuk i përmbush specifikacionet e përcaktuar në DT gjithashtu nuk qëndron ngase:



8	Karrige për zyre rrotulluese Karrige rrotulluese për zyre me dimensione 60cm x 60cm x 45cm me shpinore L = 120 me mekanizëm për ulje-ngritje ga pistoni. Karriga mbështetet me një bazament në formë ylli me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat janë me material plastike ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetëse të karrikes janë komplet nga druri dhe ngarkesë mbajtëse dhe mbulese e butë. Tapiceria është lëkure ekologjike dhe rrjeta . Ngjyra të përcaktohet nga AK.	
---	---	--

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i papabazuar.

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

3. Ju keni rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk ka prezantuar në ofertë Qarkullimin bankar për tre vitet e fundit, ndërsa tek dosja e tenderit neni 8.1 dhe 8.2 është specifikuar si në vijim:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit, në vlerë jo më pak se 60,000.00 Euro	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vullësuar dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë bankë e licencuar në Kosovë
--	-----------	--	---

Për të dëshmuar faktin për kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, qarkullimin për tre vitet e fundit i njëjti është dashur të prezantoj dëshminë qarkullimin bankar gjatë tre viteve të fundit 2020,2021,2022, ashtu siç e kemi prezantuar ne. Përdërisa nuk është ofruar dëshmia e kënaqshme për Autoritetin Kontraktues, atëherë kuptohet qartë se i njëjti OE është i papërgjegjshëm.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na keni diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu ju si autoritet kontraktues është dashur të keni në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj nuk qëndron,

Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka ofruar qarkullimin bankar ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë vetëm për vitin 2021 Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka ofruar qarkullimin prej: 1,106,264.43 Euro dhe bazuar në Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimi Publik, neni 8 pika ii

Në rastin kur kërkesa e gjendjes ekonomike dhe financiare i referohet një qarkullimi total prej në tri vitet e fundit dhe Operatori ekonomik përmbush kërkesën e përcaktuar në dokumentet e tenderit në vetëm dy vite apo një vit, konsiderohet se OE ka përmbushur kërkesën minimale.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartëcekur u vendos si në dispozitive të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit